



Thirrje për krijimin e një liste referimi të ekspertëve

Shoqata e Punëtorëve Financiar të Vetëqeverisjes Lokale dhe Ndërmarrjeve Publike (ShPF), merr pjesë në zbatimin e aktiviteteve nga projekti "Fuqizimi i Këshillave Komunal - Faza e Dytë (Empowering Municipal Councils – Phase 2)", financuar nga qeveria Zvicerane, Ministria e Vetëqeverisjes Lokale, kurse e bashkëfinancuar dhe zbatuar nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara - UNDP.

Në kuadër të aktiviteteve të projektit, ShPF duhet të përgatisë një PEFA vlerësim për grupin e parë prej 10 komunave - partnere në projekt. Për këtë qëllim nevojiten **5 (pesë) ekspertë të tipit A - ekspertë të fushës shkencore, ekspertë të pavarur**; që do të përgatisin PEFA vlerësimin në periudhën Shtator - Dhjetor 2022.

Për nevojat e projektit, ekspertët do të ofrojnë shërbime përmes punës në zyrë dhe në terren. Detajet e angazhimit janë përcaktuar në Përshkrimin e detajuar të detyrave të punës (ToR), që do të publikohen në ueb-faqen e ShPF-së: <https://zfr.org.mk/>

Inkurajohen ekspertët të aplikojnë në këtë thirrje.

Paralajmërim: Për këtë thirrje nuk janë të përshtatshëm ekspertët me statusin e nëpunësve shtetërorë, publikë dhe administrativë, të cilët kanë krijuar marrëdhënie pune në organet e pushtetit shtetëror dhe lokal dhe në organet e tjera shtetërore të krijuara në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet, si dhe në institucionet që kryejnë veprimtari me interes publik të përcaktuar me ligj, kurse të organizuara si agjenci, fonde, institucione publike dhe ndërmarrje publike të themeluara nga Republika e Maqedonisë së Veriut ose nga komunat, nga Qyteti i Shkupit, si dhe nga komunat në Qytetin e Shkupit.

Nëse jeni të interesuar, Ju lutemi dërgoni një letër të shkurtër motivimi dhe Biografinë tuaj të përditësuar me një foto jo më vonë se në orën 16:00 të hënën më 12 shtator të vitit 2022, në e-mail adresën e mëposhtme: zfr.veles@gmail.com